

Sistemi politik

Fuqia politike në Zvicër është e ndarë në tri rrafshe. Konfederata, kantone (shtetet anëtare) dhe komuna. Zvicranet dhe zvicranët mundet të votojnë për ndryshimet politike.

Shteti konfederativ i Zvicrës

Shteti konfederativ i Zvicrës ekziston prej 1848. Kryqyteti është Berni. Zvicra nuk përbën as etnikisht, as me gjuhë as me besim një unitet. Meqë kultura të ndryshme vullnetarisht janë bërë bashkë, flet njeriu për një nacionalitet dëshire (Willensnacion). Zvicra në politikën internacionale është shtet neutral.

Federata

Në Zvicër kantonet dhe komunat kanë një pavarësi të madhe, njeriu flet për federatë. Të 26 kantonet dhe mbi 2000 komuna kanë plotësisht të ndërtuara strukturat shtetërore. Kantoni i Basel-Landschaft ka një kushtetutë të veten dhe një qeveri, një parlament dhe gjyqjet. Për shumë detyra shtetërore janë kantonet apo komunat përgjegjëse. Për këtë si shembull është sistemi shkollor prej kantoni në kanton i rregulluar ndryshe. Përgjatë ligjet shtetërore vlejné për gjithë Zvicrën, kantonet i kanë ligjet e veta, të vlejné vetëm për zonën kantonale. Edhe komunat mund t`i vëjnë rregullat e veta. Për përballimin e detyrave ngrejn kantonet dhe komunat si dhe konfederata tatimet.

Ndarja e pushteteve

Për pengimin e koncentrimin të pushtetit, është pushteti shtetëror në Zvicër dhe në kantone i ndarë në tri pushtete të pavarura: Pushteti Legjislativ (pushteti legjislativ), Ekzekutiv (pushteti ekzekutiv) dhe Juridik (pushteti juridik). Në kantonin Basel-Landschaft zyrtarët i marrin këto detyra:

- Legjislativ: Këshilli i madh (Landrat) (90 anëtar, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet)
- Ekzekutiv: Këshilli qeverisës (Regierungsrat) (5 anëtarë, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet)
- Juridik: Gjyqje të ndryshme në rrafshin kantonial, si edhe gjykatat civile të rretheve civile

Edhe komunat kanë një legjislativ (mbledhje e komunës, parlament, (Gemeindeversammlung, Parlament) dhe një ekzekutiv (këshill qyteti apo komune, Stadtrat, Gemeinderat). Në rrafshin shtetëror legjislativi i ka dy dhoma: Nacional- dhe këshilli shtetëror (National-und Ständerat). Pushteti nacional (7 antëtarë) quhet këshilli konfederativ (Bundesrat). Edhe në rrafshin nacional ekzistojn gjyqje të ndryshme. Në gjyqin konfederal si instanca më e lartë mund të dërgohen p.sh. vendimet gjyqësore të kantonit.

E drejta demokratike

Të drejtat themelore më të larta në Zvicër janë të shkruara në kushtetutën konfederative (Bundesverfassung). Një pjesë e rëndësishme e kushtetutes konfederative janë të drejtat themelore, të cilat bazohen në konventën evropiane për të drejtat e njeriut (KEDN). Ato mbrojnë ekzistencën e njeriut (p.sh. e drejta për jetë, e drejta për ndihmë në situata emergjente) dhe mbrojnë individin kundër dhunës shtetërore apo grupet kundër shumicës. Ato garantojnë, që askush për shkak vendit të ardhjes, rases, besimit, gjinisë apo drejtimit seksual të mos diskriminohet. Viktimat prej diskriminimit racor marrin në kantonin e Basel-Landschaft mbështetje dhe këshillim falas. Në Zvicër mbretrojnë liria e besimit, mendimit dhe shtypit. Përveç kësaj, shpesh ekziston mundësia për t'u përfshirë në komisione, grupe interesi ose klube në vendbanimin.

E drejta themelore

Të drejtat themelore më të larta në Zvicër janë të shkruara në kushtetutën konfederative (Bundesverfassung). Një pjesë e rëndësishme e kushtetutes konfederative janë të drejtat themelore, të cilat bazohen në konventën evropiane për të drejtat e njeriut (KEDN). Ato mbrojnë ekzistenzen e njeriut (p.sh. e drejta për jetë, e drejta për ndihmë në situata emergjente) dhe mbrojnë individin kundër dhunës shtetërore apo grupet kundër shumicës. Ato garantojnë, që askush për shkak vendit të ardhjes, rases, besimit, gjinisë apo drejtimit seksual të mos diskriminohet. Viktimat prej diskriminimit racor marrin në kantonin Basel-Landschaft mbështetje dhe këshillim falas. Në Zvicër mbretrojnë liria e besimit, mendimit dhe shtypit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/sistemi-politik